



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**  
**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Alb Eagle" të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Alb Eagle shpk" të datës 07.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Alb Eagle shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 07.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet ankimore të parashtruesit:** “Kërkesat për furgon elektrik dhe gjysmë rimorkio 750kg janë të panevojshme dhe favorizojnë operator të caktuar, të cilët i posedojn këto dhe u bëjnë thirrje të tjerëve që të mos aplikojnë në këtë aktivitet të prokurimit duke aluduar në fuqinë që e posedojnë në AK. Këto kritere janë favorizues direkt për një operator ekonomik saktësisht për LOT II, ku shumë lehtë mund të verifikohet dhe do të jua dëshmojmë se ky LOT do të kushtëzon edhe operator tjerë ekonomik të interesuar të marrin pjesë në këtë procedurë. Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prishtinës saktësisht njesia kërkuese nuk ka harmonizuar buxhetin në bazë të kërkesave të dosjës së tenderit dhe njoftimi për kontratë. Vlera e Parashikuar për këtë aktivitet të Prokurimit nga AK është 2,640,000.00 € LOT I, dhe 1,344,000.00 LOT II ku në bazë të analizës sonë vetëm për paga e tejkalon vlerën e parashikuar pa llogaritur shpenzimet tjera të parapara në dosjen e tenderit. Shpenzimet totale sipas analizës sonë financiare janë për LOT I = **Kosto për 32 muaj, sipas vendimit Nr. 10/ 273- 3,057,861.44€.** dhe **Kosto per 32 muaj, sipas vendimit Nr. 10/ 273 : 1,559,714.56€.** Buxheti I ndarë është në kundërshtim me kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe në kundërshtim me vendimin e pagës minimale dhe ligjit të punës. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në bazë të dosjës së tenderit dhe kërkesave dhe vendimit të pagës minimale i duhen buxhet shtesë në bazë të analizës sonë për LOT I dhe LOT II vetëm për mbulimin e pagave buxheti i cili duhet të ndahet është si në vijim: **3,057,861.44+1,559.714.56 = 4,617,576.00€ për 32 muaj”.**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur si vijon: AK, fillimisht, ka publikuar edhe formularin për korigjimin e aktivitetit dhe njëkohësisht ka ofruar sqarimet e nevojshme të kërkuara nga ana e OE-ve të interesuar. Pavarësisht kësaj, OE ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Një qasje e tillë ndihmon AK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njëkohësisht ndihmon në eliminimin e paqartësive eventuale të shfaqura nga palët pas publikimit të njoftimit për kontratë për tenderin me titull “Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA – Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve, lot 1 dhe 2”.

Lidhur me pretendimin se pajisjet teknike të kërkuara tek Aneksi 7, janë favorizuese apo diskriminuese pa ofruar asnjë argument apo prove mbështetëse por vetëm hamendsime. AK njofton OE ankues se këto kërkesa janë vendosur në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Në kohën e sotme, pa mjete adekuate nuk mund të ofrohet shërbim cilësor. Referuar kësaj janë hartuar edhe specifikat teknike për mjetet e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve. Qëllimi i aktivitetit të prokurimit është ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e ambientit, pra të kemi ambient të pastërt, e pikërisht ofrimi i shërbimit me mjete elektrike e ofron një gjë të tillë, që ndikone në mbrojtjen e mjedisit dhe njëkohësisht ruan ndotjen e ambientit, përveç kësaj ndikojn edhe në eliminimin e zhurmës, pra janë mjete të bazuara në nevojat teknike të objekteve në të cilat do të ofrohet shërbimi dhe nuk ka të bëjë fare me kufizim. Ritheksojmë se mjetet e specifikuara tek Aneksi 7 i dosjes së tenderit janë minimumi i mundshëm për realizimin e shërbimit që duhet të posedojë kompania pretendente për ofrimin e shërbimit. Ritheksojmë se asnjë nga pajisjet e kërkuara tek Aneksi 7 nuk është jashtë natyrës së aktivitetit të prokurimit

dhe nuk bie ndesh me nenin 69 të LPP-së; përkundrazi, pajisjet e kërkuara janë vetëm minimumi përmes të cilit mund të ofrohet shërbim sa me cilesor. Mbi kete pretendimi ankimor per pajisje eshte plotesisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore rreth vlerës së parashikuar, të shprehura në pikat 4 dhe 5, vlera e parashikuar është e bazuar në vlerën aktuale të tregut. Njëkohësisht, procedura është e hapur dhe po ashtu kriteri i dhënies së kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në fazën në të cilën gjendet procedura, është hipotetike të thuhet se vlera e parashikuar është e ulët një gjë e tillë do të vërtetohet pas hapjes së ofertave të mundshme, për të cilat jemi të bindur se vlera është reale dhe e bazuar në tregun aktual të ofrimit të shërbimit të kërkuar. Mbi këtë bazë, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Si përfundim, AK ka publikuar njoftimin mbi korrigjimin e aktivitetit të prokurimit, ku ka vërejtur gabime teknike të shfaqura në dosjen e tenderit. Po ashtu, kriteret janë të vendosura në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit që është publikuar, duke marrë për bazë parimet e prokurimit, nenin 7 për mosdiskriminimin dhe nenin 6 për ekonomicitetin dhe efikasitetin e procedurës.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.